FABRIKA E MOBILEVE

INNER DESIGN

2025


CATALOGUE

*"**Mirësevini** në botën e **Inner Design,** ku çdo hapësirë transformohet në **ekselencë**, nga kuzhinat dhe dhomat e gjumit, te ambientet profesionale dhe dyert e drurit, të gjitha të krijuara me **detaje të përkryera**, stil të rafinuar dhe **cilësi të lartë** që frymëzojnë dhe mbeten të paharrueshme."*

Përmbajtja e katallogut
Catalogue content



Historia jonë
06 / 07



Kuzhina
09 / 19



Dhoma Gjumi
21 / 31



Dizajn i brendshëm
33 / 45

Historia jonë
Our story



Historia jonë

Fabrika e Mobileve Inner Design është themeluar në vitin 1987 në qytetin e Pejës, duke filluar fillimisht me përpunimin e drurit dhe prodhimin e dyerve, dritareve dhe produkteve të tjera të mobilimit. Me kalimin e viteve, kompania u zgjerua duke kaluar sfida të shumta, por gjithmonë duke ruajtur përkushtimin ndaj cilësisë dhe mjeshtërisë.Sot, Inner Design është një emër i konsoliduar në tregun kosovar dhe ndërkombëtar, duke ofruar mobilje moderne me teknologjinë më bashkëkohore dhe me partneritete ekskluzive me disa prej brendeve më prestigjioze europiane.Çdo produkt i yni kalon në testime rigoroze të cilësisë, për të siguruar që në shtëpinë tuaj të mbërrijë vetëm më e mira – e shoqëruar me vulën e mjeshtërisë dhe dashurisë për punën që bëjmë.

Inner Design, Traditë dhe Inovacion që nga viti **1987**

Në gamën tonë të gjerë do të gjeni një botë të tërë mundësish, ku secili detaj është i menduar për të pasqyruar stilin dhe shijen tuaj unike. Ne ofrojmë kombinime të pafundme dizajni, duke filluar nga format klasike që nuk dalin kurrë nga moda, e deri tek linjat moderne e minimaliste që pasqyrojnë trendet më të reja ndërkombëtare.Përveç kësaj, stilet dhe ngjyrat e ndryshme ju japin liri të plotë për të krijuar ambientin që përshtatet më së miri me hapësirën tuaj ,qoftë një shtëpi e ngrohtë familjare, një ambient pune i sofistikuar apo një hapësirë mikpritëse për mysafirë.Çdo produkt Inner Design është i personalizueshëm sipas nevojave tuaja funksionale, duke ju mundësuar të zgjidhni dimensionet, materialet dhe detajet që i përshtaten jetesës suaj. Kjo e bën çdo mobilje jo vetëm një element estetik, por edhe një zgjidhje praktike dhe afatgjatë.Në këtë mënyrë, secili produkt Inner Design përfaqëson një kombinim të përsosur mes stilësisë, funksionalitetit dhe rehatisë, duke u bërë pjesë natyrale e jetës suaj të përditshme dhe duke sjellë kënaqësi për shumë vite me radhë.



*"Ku çdo gatim bëhet **art**, dizajn që **frymëzon** **dhe funksion** që zgjedh çdo **detaj**."*

Kuzhina
Kitchen

Elegancë natyrale në çdo detaj






Inspirimi nis nga detaje të vogla natyrore ngjyra e drurit, butësia e toneve neutrale dhe drita që depërton qetësisht në hapësirë. Nga këto elemente u ndërtua një lidhje harmonike mes teksturave, formave dhe ngjyrave, duke sjellë një atmosferë të ngrohtë dhe elegante. Çdo zgjedhje vizuale është menduar për të përcjellë ndjesinë e qetësisë dhe të ekuilibrit estetik.






Kjo kuzhinë është dizajnuar duke ndërthurur drurin e ngrohtë me gurin natyral, duke krijuar një ambient modern dhe funksional. Linjat e pastra, ndriçimi i rafinuar dhe materialet cilësore e shndërrojnë hapësirën në një pikë qendrore të shtëpisë, ku estetika takon komoditetin.





Stil që flet me gjuhën minimaliste





Ishulli i kuzhinës

"Ishulli i kuzhinës shndërrohet në elementin qendror të ambientit, duke ofruar hapësirë të bollshme pune, komoditet maksimal dhe funksionalitet të përditshëm. Ai është projektuar me kujdes për të integruar ruajtjen e enëve, pajisjet praktike dhe sipërfaqet e gatimit, duke lehtësuar çdo aktivitet të përditshëm. Linjat e pastra, materialet cilësore dhe dizajni elegant krijojnë një atmosferë moderne dhe të ftohtë, ku gatimi bëhet një eksperiencë e këndshme dhe çdo moment social në kuzhinë kthehet në një përvojë të veçantë."



*"Kuzhina është zemra e shtëpisë - **Julia Child**."*



Kuzhina ideale për ju!

Kjo kuzhinë është prodhuar nga MDF i lyer në ngjyrë gri mat, i cili garanton një sipërfaqe të qëndrueshme, elegante dhe të lehtë për mirëmbajtje. Pjesa e punës dhe muri janë realizuar nga kompakt i zi me teksturë natyrale, që ofron rezistencë të lartë ndaj nxehtësisë, lagështisë dhe gërvishtjeve, duke ruajtur në të njëjtën kohë një pamje sofistikuar.Sistemi pa doreza i integruar në të gjitha elementet, thekson karakterin minimal dhe modern të dizajnit, duke i dhënë hapësirës një vijë të pastër e harmonike.Ajo që e bën këtë kuzhinë unike është balanca mes estetikës dhe funksionalitetit: materiale të përzgjedhura me kujdes, përpunim me precizion dhe një qasje dizajni që i shërben përdorimit praktik pa kompromis në stil.



Perfeksion në çdo detaj

Kabinetet e larta ofrojnë hapësirë të bollshme ruajtjeje, duke mbajtur gjithçka në rregull dhe lehtësisht të aksesueshme. Pajisjet elektrike janë të integruara në mënyrë të padukshme në strukturën e kuzhinës, duke ruajtur vijën e pastër estetike dhe duke optimizuar përdorimin e hapësirës.

Organizim dhe funksionalitet

Kjo kuzhinë nuk është thjesht një hapësirë gatimi, por një kombinim i teknologjisë moderne dhe dizajnit funksional. Çdo element është projektuar për të ofruar rehati maksimale dhe efikasitet të plotë në përdorim të përditshëm.



Përvoja e përdorimit


Nga gatimi i përditshëm tek mikpritja e miqve, kjo kuzhinë është projektuar të përshtatet natyrshëm me stilin e jetës bashkëkohore. Çdo detaj, nga organizimi i brendshëm tek sipërfaqet e punës, është menduar për të sjellë një përvojë të këndshme dhe afatgjatë.

Balancë mes errësirës dhe ngrohtësisë

Kjo kuzhinë nga Inner Design përfaqëson një stil modern me nuanca të errëta që reflektojnë finesë dhe qetësi. Kombinimi i elementeve me teksturë druri dhe sipërfaqeve xhami krijon një kontrast të ekuilibruar mes ngrohtësisë natyrore dhe elegancës urbane. Rafti i integruar për pije shton funksionalitet dhe karakter, duke e kthyer hapësirën në një zonë mikpritëse dhe të sofistikuar. Çdo detaj është menduar me kujdes për të ofruar estetikë, prakticitet dhe komoditet në përditshmëri.



Thjeshtësi në pamje



Ky projekt lindi nga dëshira për të krijuar një kuzhinë që bashkon ngrohtësinë natyrore me elegancën bashkëkohore.Kontrasti mes teksturave druri dhe xhamit, duke ndërtuar harmoni mes materialit të fortë dhe reflektimit të lehtë. Rezultati është një hapësirë funksionale, me karakter të qetë dhe estetikë që qëndron në kohë.







, elegancë në ndjesi!



Kuzhinë me stil modern dhe harmoni natyrale

Kjo kuzhinë moderne nga Inner Design është konceptuar për të sjellë një atmosferë të qetë, elegante dhe bashkëkohore në zemrën e shtëpisë. Paleta e ngjyrave neutrale ndërthuret me teksturën e ngrohtë të drurit, duke krijuar një kontrast të butë që reflekton ekuilibër dhe finesë.Shanku, me përfundim që ngjan me gurin natyral, i jep hapësirës një ndjenjë solide dhe autentike, ndërsa kombinimi me elementet prej arre shton thellësi dhe karakter. Linjat e drejta, përfundimet e pastra dhe organizimi funksional i hapësirës e bëjnë këtë kuzhinë ideale për jetesën moderne.Çdo detaj është menduar për të bashkuar estetikën me komoditetin, duke krijuar një ambient ku materiali, drita dhe funksioni bashkëjetojnë në harmoni të plotë. Kjo kuzhinë nuk është vetëm vend gatimi, por një hapësirë që frymon stil, ngrohtësi dhe personalitet.



Material i qëndrueshëm dhe elegant

Kuzhina moderne nga Inner Design është realizuar me material MDF cilësor, i njohur për qëndrueshmërinë, lehtësinë e përpunimit dhe pamjen e pastër që ofron. MDF-i mundëson krijimin e sipërfaqeve të lëmuara dhe të qëndrueshme, duke e bërë kuzhinën jo vetëm elegante, por edhe praktike për përdorim të përditshëm.MDF-i nuk është vetëm një zgjedhje estetike – ai garanton që kuzhina të ruajë pamjen dhe funksionalitetin për vite me radhë.



Tryezaria dhe muri

Tryezaria është dizajnuar në të njëjtën ngjyrë dhe stil si kuzhina, duke krijuar një vazhdimësi elegante në hapësirë.
Anash kuzhinës, muri është i mbuluar me tekstura arre dhe hiri, të kombinuara me një pasqyrë që zgjeron vizualisht ambientin. Ky kombinim i elementeve ofron ngrohtësi, stil dhe harmoni të plotë në çdo detaj.

*"Një **oaz** pushimi dhe **rehatie**, elegancë*
*që **përqafohet** çdo natë."*

Dhoma Gjumi
Bedrooms



DHOMA QË TË INS

Kjo master bedroom është krijuar për të ofruar rehati dhe elegancë në çdo detaj. Mobiljet janë moderne, duke kombinuar funksionalitetin me estetikën. Materialet e përdorura janë të cilësisë tekstilet të buta dhe detajet metalike delikate që shtojnë një prekje luksoze. Ngjyrat e qeta dhe ngrohtë dhe relaksues, perfekt për t'u çlodhur pas një dite të gjatë. Çdo element është mendua jetesës, duke ofruar një përvojë të plotë komoditeti dhe bukurie vizuale.







SPIRON

të dizajnuara me linja të thjeshta dhe
së lartë, duke përfshirë drurin natyral,
harmonike krijojnë një ambient të
ar për t'u përshtatur me stilin tuaj të

Ngjyrat e pasura dhe tekstura natyrale
e bëjne këtë furnir të arrës të vecante
duke sjellë stil dhe qëndrueshmeri në
cdo mobilje







DETAJE TË PUNUARA NË PERFEKSION

Në fabrikën Inner Design, procesi i lyerjes dhe gravimit të materialit MDF realizohet me teknologji të avancuar dhe mjeshtëri të lartë. Sipërfaqet trajtohen me ngjyra rezistente, duke siguruar uniformitet dhe qëndrueshmëri afatgjatë. Gravimi i personalizuar shton elegancë dhe detaj unik, duke e bërë çdo produkt të dallueshëm. Klientët e preferojnë këtë punim sepse kombinon estetikë moderne me cilësi të garantuar.



Tavolina e punës

E krijuar për të përmbushur nevojat e përditshme, kjo tavolinë përfaqëson balancën perfekte mes stilit modern dhe funksionalitetit praktik. Linjat e pastra dhe dizajni minimalist japin një pamje bashkëkohore, ndërsa sipërfaqja e gjerë dhe ndarjet praktike mundësojnë organizim efikas të dokumenteve apo pajisjeve teknologjike. Duke përdorur materiale të qëndrueshme dhe të punuara me përpikëri, tavolina e punës shndërrohet në një pikë referimi të dhomës, duke ofruar një ambient të qetë e produktiv për çdo aktivitet.



Këndi Grimit

Kjo hapësirë është menduar me kujdes për të ofruar jo vetëm funksionalitet, por edhe një ndjesi luksi të përditshëm. Pasqyra e integruar me ndriçim të butë krijon një atmosferë ideale për kujdesin personal, ndërsa hapësirat e organizimit janë dizajnuar për të vendosur në mënyrë praktike çdo aksesor apo produkt kozmetik. Materialet cilësore dhe përfundimi i rafinuar e bëjnë këtë zonë të jetë një element i veçantë i dhomës, duke kombinuar estetikën elegante me komoditetin e përdorimit.

Dhomë gjumi për fëmijë



DOREZA QË GARANTOJNË SIGURI DHE STIL PËR MË TË DASHURIT TONË

Dorezat e dollapëve janë dizajnuar me kujdes për të qenë të sigurta dhe të përshtatshme për fëmijët. Format e rrumbullakosura dhe materiali cilësor parandalojnë lëndimet, duke e bërë hapjen dhe mbylljen e dollapëve të lehtë dhe komode për të gjithë anëtarët e familjes. Një kombinim i stilit elegant dhe funksionalitetit praktike, që siguron rehati dhe siguri në çdo përdorim.





Një dhomë gjumi, ku çdo ditë është aventurë.









Elegancë Natyrale

Elegancë dhe rehati të përkryer. Ky ambient ndërthur ngjyrat neutrale me materiale cilësore, duke krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe të qetë. Krevati me tapiceri në nuanca bezhë sjell komoditet maksimal dhe një pamje moderne, ndërsa muri dekorativ me efekt guri i jep hapësirës karakter dhe thellësi. Dyshemeja me parket natyral në formë fishbone e plotëson harmoninë, ndërkohë që dritaret e mëdha me perde elegante lejojnë dritën natyrore të depërtojë butësisht në dhomë. Një dizajn i menduar deri në detaj, që ofron qetësi dhe stil bashkëkohor për pushim të përditshëm.

DIZAJN I PASTËR LINJA MODERNE







STIL BASHKËKOHOR






Dhomë gjumi moderne dhe minimaliste

Kjo dhomë gjumi kombinon stilin modern dhe minimalist me ngjyrat e ngrohta bezhe, duke krijuar një ambient elegant, të qetë dhe harmonik. Dollapët me xham të errësuar dhe komodinat harkore të punuara me MDF shtojnë rafinim dhe finesë, ndërsa muri pas shtratit dhe zona e tavolinës së punës dhe makeup-it janë të mbuluara me teksturë bungu, që i japin hapësirës thellësi, karakter dhe stil unik. Çdo detaj është menduar për të bashkuar estetikën me funksionalitetin: mobilimi, drita dhe materialet bashkëjetojnë në mënyrë perfekte, duke krijuar një hapësirë të organizuar dhe vizualisht të këndshme. Ky ambient ofron komoditet maksimal dhe një ndjesi të qetë, ku çdo element, nga mobilimi te përpunimi i materialeve – kontribuon në elegancën dhe sofisticimin e përgjithshëm të dhomës.





DETAJE QË FLASIN VETË





*"**Ambientet** që frymëzojnë, **stil dhe funksion***
*që mbeten në **mendje**."*

Dizajn i brendshëm
Interior Design

Harmoni mes drurit, gjelbërimit dhe rafinimit modern

Kjo hapësirë është konceptuar dhe realizuar nga ekipi ynë me përkushtim ndaj çdo detaji. Pjesa e murit ku janë ekspozuar pijet është punuar me kujdes të veçantë, duke ndërthurur elegancën me funksionalitetin. Struktura e ndarjeve vertikale dhe horizontale krijon një ritëm vizual që e bën këtë mur jo vetëm praktik, por edhe element dekorativ të ambientit.Ngjyra e gjelbër e thellë e mobiljeve harmonizohet në mënyrë të përkryer me tonet e ngrohta të drurit natyral, ndërsa ndriçimi i integruar thekson konturet e rafteve dhe nxjerr në pah butësisht shishet e ekspozuara. Ky kontrast mes ngjyrave të tokës dhe nuancave elegante të shisheve krijon një atmosferë të sofistikuar, ku ngrohtësia dhe rafinimi bashkohen në një përvojë unike vizuale.Rezultati është një hapësirë që të fton të ndalesh, të shijosh dhe të përjetosh harmoninë mes dizajnit modern dhe ngjyrave të zgjedhura me kujdes.

Klienti: Buçuku Steak House - Pejë













Kur shija dhe komoditeti bashkohen, çdo darkë bëhet speciale







Kur dizajni bashkëkohor takohet me precizionin dhe elegancën

Projekti i dyqanit Alfa Optica është realizuar nga Inner Design me fokus të veçantë në krijimin e një ambienti modern, funksional dhe të ftuar për klientët. Që nga koncepti fillestar, dizajni synon të përmirësojë eksperiencën e vizitorëve duke kombinuar estetikën me prakticitetin.Të gjitha elementet e brendshme janë punuar me MDF të lyer në ngjyrë hiri metalik, një zgjedhje që i jep finesë dhe ndriçim hapësirës.Pikat rrethore të ekspozimit janë jo vetëm atraktive vizualisht por edhe funksionale, të krijuara me përpikmëri për të ofruar përvojën më të mirë të klientit.

Klienti: Alfa Optica by Nautilus - Prizren












ANNE MARII
SOLANO
JENS HAGEN
CLIP-ON







PUNË E KRYER NË PE

Ky projekt i brendshëm reflekton një qasje bashkëkohore ndaj estetikës dhe funksionalitetit, ku çdo element ës
komoditetit dhe finesës vizuale. Panelizimi në dru të errët sjell ngrohtësi dhe thellësi, duke kontrastuar në mëny
kaviljeje, i cili shton dinamikë dhe vazhdimësi vizuale në hapësirë. Ndriçimi i integruar linear dhe dritaret e mëdh
dhe duke i dhënë ambientit një karakter modern e të qetë.Mobilimi është zgjedhur me kujdes për të garantuar
mënyrë harmonike me sipërfaqet e errëta të tavolinave dhe elementëve të tjerë funksionalë. Organizimi i hapës
ngrënies dhe pamjen e jashtme. Transparenca e shkallëve me xham, si dhe lehtësia vizuale e mobiljeve, sjellin n
formave përçon një atmosferë të sofistikuar, ku luks i përmbajtur bashkohet me rehati të përditshme, duke e b









RFEKSION

s për të krijuar një ekuilibër të përsosur midis
e bardha dhe dyshemenë në parket me model
atyrore, duke theksuar linjat e pastra arkitekturore
dhe karriget me tonet neutrale ndërthuren në
fluid, duke lidhur natyrshëm zonën e ndenjjes,
irie. Kjo ndërthurje e materialeve, ngjyrave dhe
ull të dizajnit bashkëkohor të nivelit të lartë.


Atmosferë ku gjërat luksoze frymojnë

Çdo element i këtij interieri është konceptuar me kujdes për të reflektuar finesën dhe shkëlqimin e bizhuterive që ekspozohen në të. Kombinimi harmonik i drurit natyral, travertinit dhe ngjyrave të buta tokësore krijon një atmosferë të ngrohtë, elegante dhe mikpritëse. Përtej estetikës, është menduar edhe funksionaliteti – nga mobiliet e personalizuara e deri te ndriçimi i rafinuar, çdo detaj shërben për të theksuar bukurinë dhe vlerën e çdo krijimi të ekspozuar. Ky dizajn jo vetëm që ofron një përvojë vizuale unike, por edhe i jep klientit ndjesinë e qetësisë dhe luksit në çdo hap.



Klienti: Argjendaria Dardani - Istog









Estetikë *funksionale me* ***materiale natyrore***





Hapësira që flet

Një shank që sjell ngrohtësi, elegancë dhe atmosferë mikpritëse në restorant, duke ftuar klientët të qëndrojnë dhe të shijojnë momentin. Materialet dhe ndriçimi i zgjedhur me kujdes e bëjnë praktik dhe vizualisht tërheqës, duke krijuar një pikë takimi ku funksioni dhe estetikë bashkohen në mënyrë harmonike dhe moderne.

Klienti: Resort Ujvara e Drinit - Pejë














Frymëzimi ynë erdhi nga dëshira për të kombinuar luksin dhe natyrshmërinë në një hapësirë publike të pritshme. Ideja fillestare erdhi nga harmonizimi i materialeve natyrore dhe elegantë, si mermeri jeshil, druri i lisit dhe tekstura të pasura të pemëve, të cilat krijojnë një ndjesi të qetë dhe mikpritëse. Përdorimi i dyshemesë me model "herringbone" dhe ndriçimi i ngrohtë e i butë e thekson bukurinë e këtyre elementeve, duke i dhënë hapësirës një karakter organik, por njëkohësisht të rafinuar.Me këtë frymëzim, është krijuar një recepsion hoteli që jo vetëm impresionon vizualisht, por edhe fton mysafirët të ndihen të mirëpritur. Çdo detaj është menduar për të kombinuar funksionalitetin me estetikën, duke e bërë zonën e pritjes një përvojë të veçantë që reflekton elegancën dhe kujdesin për materialet dhe kompozicionin.


Kombinim mes ngjyrave dinamike dhe atyre natyrale



Klienti: Powergroup - Prishtinë







Ky dizajn i brendshëm nga Inner Design sjell një atmosferë dinamike dhe bashkëkohore për hapësirat e punës. Tonet e ngrohta të ndërthurura me elemente neutrale krijojnë energji dhe gjallëri, duke i dhënë çdo punonjësi motivim dhe fokus gjatë ditës. Mobiliet ergonomike dhe raftet e integruara ofrojnë komoditet dhe organizim maksimal, ndërsa ndriçimi i përshtatur me kujdes thekson arkitekturën e thjeshtë, por të sofistikuar. Një zgjidhje që bashkon estetikën me funksionalitetin, duke e bërë këtë ambient ideal për kreativitet dhe produktivitet.



*"**Faleminderit** që eksploruat botën e **Inner Design**. Çdo projekt, qoftë për shtëpi, biznes apo ambient profesional, është një shprehje e **ekselencës**, funksionalitetit dhe **stilit** të rafinuar. Ne krijojmë hapësira që **frymëzojnë** dhe qëndrueshmëri që mbetet."*

FABRIKA E MOBILEVE

INNER DESIGN

Fabrika e Mobileve

Rr. Dëshmorët e Hotit
Pejë, Republika e Kosovës 30000
+ 383 (0) 49 623 133

Showroom Prishtinë

Magjistralja Prishtinë - Ferizaj
Prishtinë, Republika e Kosovës 10000
+ 383 (0) 49 639 525

Showroom Pejë

Rr. Bekim Berisha
Pejë, Republika e Kosovës 30000
+ 383 (0) 49 639 522

wwww.innerdesign-ks.com